

UDHËZIMI 2

MBI TRANSFERTAT E VEPRIMEVE JOTREGTARE NË VALUTË

1. Në transfertat e veprimeve jotregtare përfshihen:
 - a) studime dhe kontrolle të kryera nga shoqëri të huaja;
 - b) kurse, konferenca dhe konkurse jashtë vendit;
 - c) studime, specializime dhe trajnime jashtë vendit;
 - d) shërbime shëndetësore dhe mjeksore jashtë vendit;
 - e) ekspertiza teknike, komisione për planifikimin dhe kontrollin, që kanë lidhje me ndërtimet, me zbatimin e projekteve dhe me planifikime të tjera;
 - f) përpunimi elektronik i të dhënave;
 - g) planifikimi teknik dhe administrativ;
 - h) qira të filmave dhe të programeve televizive dhe pagesat për të drejtën e autorit;
 - i) shpenzime korente të degëve dhe të zyrave të përfaqësimit të shoqërive dhe të bankave, si qiratë, shpenzimet operative etj., misionet diplomatike shqiptare dhe të huaja, misionet tregtare, forcat paqeruajtëse, programet e këmbimit kulturor dhe të nxitjes së turizmit;
 - j) patentat dhe të drejtat e autorit, pagat dhe rrogat e zakonshme, shpenzimet e natyrës joperiodike të jorezidentëve;
 - k) qira financiare të pajisjeve operative dhe të makinerive;
 - l) qira financiare afatshkurtra (deri 1 vit);
 - m) shlyerja e huave;
 - n) pensione;
 - o) pagesa për anëtarësi;
 - p) asistencë e dërguar organizatave fetare;
 - q) transaksione me organizatat ndërkombëtare;
 - r) qira të ndryshme në favor të emigrantëve dhe të jorezidentëve;
 - s) shpenzime jetese familjare, në përputhje me nenin 5, pikat b dhe c.
2. Në transfertat e veprimeve jotregtare përfshihen edhe të gjitha transfertat e tjera, të ngjashme me ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.
3. Me qëllim kryerjen e transfertave të përcaktuara në këtë udhëzim, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:
 - a) kërkesën sipas pikës 1.1. gërma a të udhëzimit nr. 1;
 - b) vërtetimin (në rast se është e mundur), nga një organ kompetent, që justifikon qëllimin e veprimit sipas këtij udhëzimi;
 - c) vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore për personat fizikë dhe juridikë.